



DEKLARATË PËR MEDIA

Centre for Legal Empowerment (CLE) po ndjek me vëmendje ngjarjen lidhur me shtetasin J.R., ndaj të cilit u caktua masa e sigurisë “arrest me burg” dhe më pas u dërgua me urgjencë në gjendje të rëndë shëndetësore në Spitalin Universitar “Nënë Tereza” në Tiranë.

Në lidhje me këtë ngjarje, CLE, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të P.R. (nëna e J.R.) është informuar nëpërmjet Epikrizës së vendosur në dispozicion nga Spitali Universitar “Nënë Tereza” në Tiranë se: *“shtetasi J.R. është gjetur nga Stafit Mjekësor i Urgjencës së Tiranës në ambientet e komisaritit jo koshient, pa puls periferik, me puls central dhe në kushtet e bradipnesë. (...) Nga konsulta e toksikologut pacienti kishte 4 ditë që kishte filluar terapinë zëvendësuese me Metadon”.*

Deklarata e publikuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë përcjell vetëm informacionin për njoftimin e Stafit Mjekësor të Urgjencës së Tiranës, sepse shtetasi J.R kishte shfaqur shqetësime shëndetësore.

CLE dhe avokatët e saj shprehin shqetësimin e tyre për mospasqyrimin në deklaratën për shtyp të datës 02.05.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë të informacionit për fillimin e terapisë zëvendësuese me Metadon gjatë 4 ditëve të fundit për pacientin (pra gjatë kohës së qëndrimit në Bllokun e Sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë).

Mbështetur në sa më sipër, CLE, adreson këto pyetje me qëllim zbardhjen sa më të shpejtë të të gjitha rrethanave të kësaj ngjarjeje:

- Cilat kanë qenë veprimet e kryera në Bllokun e Sigurisë së Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë ndaj shtetasit J.R.?
- Cilat janë përgjegjësitë e IEVP 313, që nuk ka pranuar që ta marrë në dorëzim shtetasin J.R. për shkak të mbingarkesës në këtë institucion?
- A i është nënshtruar i paraburgosuri një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit në momentin e vendosjes së tij në paraburgim?
- Cili ka qenë shkaku që Znj. P. R. (nëna e J. R.) është njoftuar pas 11 ditëve për gjendjen e rëndë shëndetësore të djalit të saj dhe për shtrimin e tij në spitalin universitar “Nënë Tereza”?



DEKLARATË PËR MEDIA

Mbas njoftimit të datës 30 prill për ngjarjen e lidhur me shtetasin J.R. dhe gjendjen e tij të rëndë shëndetësore CLE, nëpërmjet bashkëpunimit të avokatëve dhe paraligjorëve të saj pranë komunitetit Rom, vazhdon të ndjek hap pas hapi zhvillimet e kësaj çështjeje.

CLE dhe familjarët e shtetasit J. R. vijojnë të kërkojnë një përgjigje të shpejtë dhe të plotë për sqarimin e të gjitha rrethanave dhe shkaqeve që kanë shkaktuar dëmtimin dhe gjendjen e rëndë shëndetësore të shtetasit gjatë qëndrimit të tij në paraburgim.